VENDIM
Nr.768, datë 2.11.2011

PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË, TË DOKTORATËS, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuotave të pranimit, gjithsej 1367, për programet e studimeve të ciklit të tretë të studimeve, të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2011-2012.

2. Kuotat e pranimit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimeve, për çdo institucion publik të arsimit të lartë, pasqyrohen në kolonën F të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kuotat e pranimit për kandidatët nga brenda territorit të vendit, gjithsej 1203, pasqyrohen në kolonën D të tabelës nr.1 dhe për kandidatët nga trojet jashtë kufijve të vendit, gjithsej 164, pasqyrohen në kolonën D, të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Tarifa e shkollimit për programet e studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, për çdo institucion publik të arsimit të lartë, sipas pikës 1, të këtij vendimi, është 208 000 (dyqind e tetë mijë) lekë. Tarifa e shkollimit paguhet në këste të përcaktuar nga institucioni publik i arsimit të lartë.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i secilit institucion publik të arsimit të lartë, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha